



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

“Për disa ndryshime për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”

Konsultim publik : I Hapur

Data : 27.12.2023

Ora : 12.00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1 date 22.01.2016 për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.

Pjesëmarrës : Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli. Drejtues dhe Specialistë të Bashkisë Shkodër, qytetarë dhe grupe interesi,

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Prezantimin e ndryshimeve të parashikuara për paketën fiskale e **Z.Bekim Mema**, i cili në mënyrë të detajuar prezanton këtë paketë dhe shprehet që kjo paketë do ketë një vision të reflektimit të një bashkie me një bazë të zgjeruar taksapaguesish duke rritur kapacitetet financiare dhe miradministrimin e të ardhurave në përmbushje të funksioneve të saj.

Nisma e propozimeve për ndryshimet në paketën fiskale ka lindur si rezultat i ndryshimeve ligjore që janë bërë gjatë këtyre viteve. Gjithashtu prej iniciativave të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me manaxhimin dhe zgjerimin e territorit, shërbimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve sa ma cilësore. E gjitha kjo me qëllim kryesor të administrimit efektiv të resurseve njerëzore, financiare për të krijuar një sistem fiskal që i përgjigjet zhvillimit të territorit dhe potencialeve tona. Ai vijon konkretisht me citimin e propozimeve të

parashikuara në paketën fiskale dhe rëndësinë e këtyre ndryshimeve në taksa dhe tarifim sipas materialit të përgatitur nga specialistët e administratës, nga drejtoritë përkatëse.

Fjalën e merr **Z.Imeldi Sokoli**, i cili pyet se cila është analiza apo studimi i bërë, në të cilën është bazuar rritja e këtyre tarifave, duke filluar tek taksa e ndikimit në infrastrukturë e duke vazhduar me taksat që kanë të bëjnë me tregtimin etj. Nga sa u prezantua, thotë ai kjo rritje taksash ka një efekt pozitiv vetëm për institucionin e bashkisë duke rritur investimet apo performancën e saj financiare. Ai pyet, a ka efekte negative dhe cilat janë ato? Nëse po a është menduar ndonjë plan që e zbut këtë efekt negativ?

Përgjigjet **Z.Taulant Dibra**, drejtor në drejtorinë e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Bashkinë Shkodër, duke thënë se ne kemi propozuar rritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 4 zona të rëndësisë së veçantë të qytetit nga 4% në 8%, Për pjesën më të madhe të Shkodrës nga 4% në 6% të vlerës së shitjes dhe kemi mbajtur të pandryshuar për pjesën tjetër. Gjithmonë bëhet fjalë këtu për ndërtime të destinuara për qëllime banimi, njësi tregtimi dhe shërbimi të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi përse i përket shitjes apo përfitimit. Ndërkohë që niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime që destinohen për industri, turizëm, ndërtim individual për qëllime përdorimi vetjak, të ndërtuara nga vetë individi apo sipërmarrës të ndryshëm nuk ka ndryshim takse, mbetet në kuotën e 3% të vlerës së preventivit të ndërtimit. Kurse për sektorin bujqësor, blegtoral apo objekteve sportive taksa do bëhet 1%, pra kemi ulje të saj. E thënë ndryshe nuk është propozuar rritje takse por thjesht indeksim irritjes së çmimeve.

Z.Sokoli shprehet se efekti i parë që kjo rritje do sjell është rritja artificiale e çmimit që përfundon direkt me kosto tek qytetarët. Po ahtu ai shton se edhe rritja e taksës së tregtimit do ketë efekt direkt në informalitet dhe rritje çmimesh të produkteve. Ai mendon se së pari duhet konsoliduar baza e tregtarëve që tregtojnë në qytet dhe më pas të shihet se si mund të rrisim në mënyrë të pranueshme tarifimin.

Z.Luli shtron një pyetje lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, duke thënë se qyteti është ndarë në zona, ku taksa nuk është e njëjtë. Pse është parashikuar ky diferencim sidomos për zona, në të cilat kalojnë akse rrugore kombëtare me potencial biznesesh?

Përsëri përgjigjet **Z.Dibra** duke sqaruar se flitet vetëm për objekte që kanë destinacion final shitjen në të kundërt taksa vazhdon të mbetet 3% e preventivit.

Fjalën e merr **Znj.Shestani**, e cila shprehet se Shkodra ka në rajon nivelin më të ulët të produktit të brendshëm bruto në lidhje me sipërfaqeve të banuara sipas lejeve të ndërtimit të miratuara. A mendoni se është rritur kaq shumë kërkesa për ndërtime në Shkodër?

Përgjigjet **Znj.Brunilda Kraja** duke thënë se në vitin 2022 kemi pasur një bum ndërtimesh dhe kjo lidhet me planifikimin e qytetit. Tani kemi kërkesë të shtuar të ndërtimit të objekteve të mëdha, të cilat janë në proces shqyrtimi për ç'ka lejohet apo jo në zona të caktuara të qytetit.

Fjalën e merr **Znj.Jona Leqejza** e cila mendon se rritja e taksës në infrastrukturë sipas saj përveç detyrimit ligjor që bashkia ka që të ardhurat që vjel nga kjo tarifë t'i rikthej në investime publike, është edhe parim ekonomik shumë i thjeshtë: në qoftë se rritet tarifa synimi është të ulë incentivën e ndërtimeve. Kurse në lidhje me taksën e tregut ajo pyet **Z.Sokoli** se sa mendon se duhet të jëtë ajo dhe pse?

Përgjigjet **Z.Sokoli** duke thënë se sa duhet të jetë taksa, këtë duhet ta përcaktojë studimi dhe jo qejfet e bashkisë. Duhet të ketë një vlerësim apo analizë të detajuar të kryer për këtë. Nëse ka nevojë për shfrenim të ndërtimeve, Bashkia ka instrumenta të tjerë plot, që mund të jetë p.sh plani i territorit. Për më tepër ne nuk kemi pse orientojmë tregun e ndërtimit dhe të hyjmë në konkurrencë me ndërtuesit. Bashkia duhet të garantojë një barazi pa çënuar tregun.

~~**Z.Mema** përgjigjet në lidhje me tarifën e tregut duke u shprehur se ky propozim për rritje nuk ka ardhur nga hiçi por pas një analize dhe studimi të bërë që nga viti 2016 nga një strukturë shumë e mirë monitoruese dhe një bazë të dhënash shumë e mirë përsa i përket taksave dhe tarifave vendore. Deri tani nga taksat e vjelura nga tregu i Rusit nuk arrijmë të mbulojmë as mirëmbajtjen dhe as shpenzimet e energjisë dhe ujit.~~

Z.Bjanku shprehet se në kontekstit dhe të asaj që duhet të shërbejë degjesa publike duhet të kishte pjesëmarrje të grupeve të interesit por vërehet që ka një indiferencë nga ana e tyre edhe pse është bërë njoftimi publik.

Znj.Bajraktari kërkon të dijë se sa ka qënë tarifa aktuale për tregun e Rusit? Kjo rritje kaq e madhe tarifimi a i është bërë e njohur tregtarëve aty? Dhe si do veprohet me tregtarët që e paguajnë këtë taksë dhe atyre që tregtojnë produktet e tyre në rrugë? A është menduar një sistemim për ato?

Përgjigjet përsëri **Z.Mema**, dhe thotë që patjetër që tregtarët janë njoftuar për ndryshimet. Brenda kësaj jave do lidhim kontratën me operatorin ekonomik që do kryej edhe investimin. Për tregtarët është më e rëndësishme konkurrenca nga tregtarët që shesin në rrugë se sa rritja e tarifës. Prandaj është një prioritet i joni krijimi dhe orientimi i tyre në tregje për të eliminuar një numër të madh ambulantësh.

Znj.Leqejza përsëri kërkon të dijë nëse ka patur raste për leje nga ndërtues për sipërfaqe të mëdha ndërtimi që kalojnë në fonde sociale dhe a ndikon ndopak ndryshimi i tarifës në këtë rast?

Përgjigjet **Znj.Kraja**, e cila thotë se sigurisht që ka patur leje ndërtimi të miratuara nga Bashkia Shkodër me sipërfaqe ndërtimi mbi 2000 m², ku subjektet ndërtues kanë siguruar kalimin prej 3% të depozitimit të akteve përkatëse dhe në momentin e përfundimit të ndërtimit të këtyre objekteve realizohet edhe kontrata e bashkisë Shkodër me këto subjekte për kalimin e sipërfaqes 3% në favor të fondit social të banesave.


Fjalën e merr **Znj.Kopliku** e cila pyet se si do t'i vijë në ndihmë tregtarëve shoqëria e krijuar së fundmi "Bio Strajca"?

Z.Mema sqaron se shoqëria “Bio Strajca” do ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe të produkteve duke qënë se ajo do merret me menaxhimin dhe strukturimin real të sektorit të tregut.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka . Z.Luli falenderon pjesëmarrësit dhe e deklaroi dëgjuesën për paketën fiskale të mbyllur.

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti



SEKRETAR































Denis Lesha

04.27.12.2023

DEGJESE PUBLIKE MBI NDRYSHIMET NE PAKETEN FISKALE

LISTE PREZENCE

Nr.	Emri Mbiemri	FSHATI	Kontakt	e-mail	Firma
1	Vino Nubours	B. Nubours	0694611662	vinonubours@gmail.com	
2	Rudino Shyqja	Bashkës Shkodër	0673448813	rudinshyqja@llm.com	
3	Anila Pajari	Bashkës Shkodër	065494568	anilapajari@posteo.net	
4	Guelda Kufala	B. Shkodër	—	gueldakufala@yendo.com	
5	Zvira Beqimi	B. Shkodër	06202020144	—	
6	Elma Piramaj	B. Shkodër	0685618000	elmapiramaj@posteo.net	
7	Elton Blyty	B. Shkodër	0694104038	eltonblyty@posteo.net	
8	Fitore Kozaj	B. Shkodër	0684013594	fitorekozaj@posteo.net	
9	Blaina Koshji	B. Shkodër	069752606	blainakoshji@gmail.com	
10	Isma Kufalica	Bashkës Shkodër	0695785017	ismakufalica@posteo.net	

Nr.	Emri Mbiemri	LAGJA/FSHATI	Kontakt	e-mail	Firma
11	Besmir Noblli	Shkoder	692404375		
12	Hajro Selim Krasniqi	SHKODER	695123813		
13	Drrika Malaj	SHKODER	698003195		
14	Aneta Jakubi		0676003026		
15	Arben Berishi		0699224549		
16	Shkëlqim Sema		0684803674		
17	Artur Buda	SHKODER	0695324024		
18	Blendi Haxhi	SHKODER	0674903435		
19	Arif Ahmeti	K.B.			
20	Arben Buda	K.B.	0684021694		
21	Arben Sela	K.B.	0682080805		
22	Florin Spasari	K.B.			
23	Erion Nishani	ISHIDA SLID			
24	Brunilda Kajo	ISHIDA SHKODER	0692112010		
25	Fida Muleci			mycalindbookline	
26	Arben Nishani	K.B.			
27	Yona Depaj	K.B.			
28	Rezarta Rade	K.B.	0692437830	rezartapade@yahoo.com	
29	Volgjeta Bajraktari	K.B.	0672784493		